



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. _____ prot.

Himarë , më 26.01.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike E-mail datë 17.01.2022.

Znj. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 17.01.2022 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë.

Në vijim të kërkesës suaj, në lidhje me pikat e referuara si më poshtë:

1. Nuk kemi të dhëna në shifra se sa familje janë të pastreha në vend , pasi nuk kemi pasur kërkesa drejtuar institucionit tonë.
2. Nuk kemi familje të strehuara , pasi nuk disponojmë banesa sociale ne si institucion.
3. Bashkia Himarë, si shumë bashki të tjera të vogla, nuk e procedojmë aplikimin për kredi të zbutur.
4. Nuk ka pasur abuzime, pasi nuk ka pasur një procedure nga ne si institucion, që të ketë mundësi përfitimi apo abuzimi.
5. Nëse do kishte një procedurë të tillë, sugjerimet apo masat e marra nga ana jonë si institucion , për kufizimin e abuzimeve , do ishin:
 - Verifikimi në terren, plotësimi i dokumentacionit në mënyrë që të dëshmoje që nuk disponohet asnjë pronë në emër të aplikuesit.
 - Verifikim dhe bashkëpunim me institucionet e rregjistrimit të pronave.
 - Verifikim i të ardhurave dhe numri i pjestarëve në certifikatën e trungut familjar.
6. Nuk kemi një informacion ligjor në shifra se cila bashki apo qytet ka më shumë të pastrehë. Por, nisur nga hapsira gjeografike ,ajo demografike dhe migrimin , mendojmë se Bashkia e Tiranës është qyteti me më shumë të pastrehë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!